



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Has më 26.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Dru Zjarri“

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- 03413000-8 - Dru zjarri

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,652,352 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) Leke pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Has ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). **Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.**

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Te plotesoj kriteret e përgjithshme sipas shtojcës 8. Objekti i prokurimit të jetë i parashikuar në ekstraktin e operatorit ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për tre vitet 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera mesatare e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës
2. Kopje e vërtetuar e bilancit të vitit të fundit 2022 të paraqitur pranë Administratës Tatimore të konfirmuar nga ky autoritet. *ku të paktën në dy bilance të njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Nisur nga vlera e xhiros vjetore që deklaron një subjekt ekonomik, varet kapaciteti financiar i tij i cili përket ne kapacitet për të realizuar kontratën objekt prokurimi

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë i ndryshuar.

(Shënim: *citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

Neni 29, Cdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

(Shënim: *citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese*).

2.3 Për kapacitetin teknik:

- 3 Dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë *jo më të vogël* se 20% të vlerës së përlogaritur të

kontratës, që prokurohet që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes, (faturat duhet të jënë të deklaruara ne organet tatimore) ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, *te plotesuara sipas legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruara ne organet tatimore..*”

2.Liçensa profesionale lidhur me mallrat objekt i kontratës

3.Te pakten nje makine transportuese, kamion.

Per te deshmuar kete, operatoret ekonomike duhet te paraqesin dokumentat e meposhtme:

- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, nese jane ne pronesi, duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne regjistrimin e mjetit leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor.

- Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publik, nese jane me qera, duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne regjistrimin e mjetit leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor, si dhe kontrata perkatese e qerases e vlefshme gjate zbatimit te kontrates.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Nese operatori ekonomik ka realizuar me sukses nje kontrate e cila i pergjegjet 20% te vleres se fondit limit atehere ai ka kapacitet per te realizuar kontraten ne fjale. Percaktimi i kesaj vlere eshte bere ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

- Drute duhet te dorezohen ne çdo objekt (*zyra, shkolla, kopshte dhe çerdhe*) prane Njesive Administrative te Bashkise Has, dhe te sistemohen me qellim matjen e tyre.
- Drute duhet te jene te stivosura ne objekt dhe do te merren ne dorezim sipas grafikut te nenshkruar midis operatorit ekonomik dhe AK-se, brenda orarit zyrtar te punes dhe jo ne dite pushimi apo festash zyrtare.
- Furnizimi do te behet nga kontraktuesi me automjetin e tij nga pika e furnizimit deri ne destinacion sipas grafikut te levrimit mallit.

- Ne rast se malli objekt prokurimi (dru zjarri) nuk ploteson kerkesat dhe standartet teknike, nuk do te merret ne dorezim.
- Malli do te merret ne dorezim sipas afatit te percaktuar ne DST
- Malli do te dorezohet brenda orarit zyrtar te punes dhe jo ne dite pushimi apo festash zyrtare.
- Furnizimi do te behet nga kontraktuesi me automjetin e tij nga pika e furnizimit deri ne destinacion Ne rast se malli objekt prokurimi, nuk ploteson kerkesat dhe standartet teknike, nuk do te merret ne dorezim.
- Per detaje me te veçanta do te percaktohen ne kontraten objekt prokurimi me operatorin ekonomik (OE) te shpallur fitues.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.